



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. ____ prot.,

Tiranë _____.____.2025

V E N D I M

Nr. 27, datë 14. 11. 2025

PËR

MIRATIMIN PËR KËSHILLIM PUBLIK TË DOKUMENTIT: “RREGULLORE E ANALIZËS SË TREGUT”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z. Gentian	Sala	Kryetar
Znj. Edlira	Dvorani	Anëtare
Z. Lorenc	Bako	Anëtar
Z. Bleron	Dokle	Anëtar
Z. Armer	Juka	Anëtar

dhe sekretare znj. Xhilda Hoxha, në mbledhjen e datës 14 nëntor 2025, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, dhe Rregulloren e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, si dhe ligjit nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, me propozim të Drejtorisë së Tregjeve dhe Masave Rregullatore, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin për këshillim publik të dokumentit – “Rregullore e analizës së tregut”

BAZA LIGJORE:

1. Në zbatim të neneve 12, 13, 44 dhe 89 (pika 1), si dhe në përputhje me përcaktimet e Kreut XIII, XIV dhe XV të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.
2. Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” (Ligji nr. 44/2015);
3. Rregullore për Procedurat e Këshillimit Publik, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 21, datë 7.12.2021.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Dokumenti: Projekt “Rregullore e analizës së tregut”.
2. Projektvendimi i formatuar dhe arsyetuar;
3. Relacioni shoqërues i projektvendimit,

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. AKEP, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për komunikimet elektronike, çmon si të domosdoshme hartimin e dokumentit “Rregullore e analizës së tregut”, duke e përshtatur me kërkesat dhe parimet e ligjit nr. 54/2024, me qëllim sigurimin e përputhshmërisë, transparencës dhe efektivitetit rregullator në tregun e komunikimeve elektronike. Rregullorja është përgatitur në përputhje me ndryshimet e sjella nga ligji i ri dhe me nevojën për krijimin e një mjedisi më të parashikueshëm për operatorët e tregut.
2. Dokumenti për këshillim publik synon adresimin e rregullave që ndikojnë zhvillimin e sektorit të komunikimeve elektronike, duke pasur si qëllim krijimin e një mjedisi konkurrues dhe të mbrojtur për të gjithë aktorët e tregut. Rregullorja përmban procedura të detajuara për vlerësimin e tregjeve dhe të fuqisë së ndjeshme në treg, duke siguruar mbikëqyrje të drejtë dhe transparente nga AKEP, si dhe mekanizma për konsultimin publik, miratimin e masave rregullatore, rishikimin dhe monitorimin e tregjeve, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe angazhimet ndërkombëtare.
3. Dokumenti përcakton listën e tregjeve për ndërhyrje ex-ante dhe procedurat për identifikimin e tyre, në përputhje me ligjin nr. 54/2024. Ai përfshin dispozita mbi detyrimet e operatorëve me fuqi të ndjeshme në treg, masat rregullatore përkatëse dhe mekanizmat e ndërhyrjes ex-ante, me synim krijimin e një tregu më konkurrues dhe mbrojtjen e interesave të përdoruesve fundorë.
4. Dokumenti për këshillim publik “Udhëzim për procesin e analizës, përcaktimin e tregut dhe vlerësimin e fuqisë së ndjeshme në treg (FNT) në sektorin e komunikimeve elektronike”, është

në përgatitur në referencë të ligjit nr. 54/2024 dhe në përputhje me Udhëzuesin e Komisionit Evropian për analizën e tregut. Ky udhëzim do të shërbejë si referencë metodologjike për të gjitha proceset e analizës që zhvillohen nga AKEP.

5. Në referencë me përcaktimet e nenit 44 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe në përputhje me “Rregulloren për Procedurat e Këshillimit Publik”, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 21, datë 7.12.2021, AKEP çmon si të arsyeshme nxjerrjen për këshillim publik të projektaktit administrativ “Rregullore e analizës së tregut”. Publikimi i këtij dokumenti përbën një hap të rëndësishëm për përfshirjen e të gjithë aktorëve të interesuar dhe për të siguruar që rregullorja e re pasqyron nevojat reale të mbikëqyrjes së tregut.
6. Pas përfundimit të procesit të këshillimit publik me palët e interesuara dhe përfshirjes së komenteve dhe kontributeve të marra gjatë këtij procesi, AKEP do të vijojë me vendimmarrjen për miratimin e dokumentit përfundimtar të aktit rregullator “Rregullore e analizës së tregut”.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Në mbështetje të pikave 1 të neneve 14 dhe 15 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Drejtues i AKEP

V E N D O S I:

1. Të miratojë nxjerrjen për Këshillim Publik të dokumentit “Rregullore e analizës së tregut”, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Procedura e Këshillimit Publik të kryhet për një periudhë 30 ditore nga data e publikimit të dokumentit në faqen e internetit të AKEP.
3. Ky Vendim dhe Dokumenti për Këshillim Publik “Rregullore e analizës së tregut”, të publikohen në faqen e internetit të AKEP : www.akep.al.
4. Ngarkohet Drejtoria Rregullatore dhe Mbikëqyrjes së Tregut për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	Edlira Dvorani	Lorenc Bako	Bleron Dokle	Armer Juka